

VENDIM
Nr.35, datë 13.1.2005

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN SANITARO-VETERINARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës të Moldavisë, për bashkëpunimin në fushën sanitaro-veterinare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE MIDIS KËSHILLIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN SANITARO VETERINARE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Moldavisë, të referuara më poshtë “Palë Kontraktuese”,

me qëllim zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e shëndetit të kafshëve,
duke i kushtuar një kujdes të veçantë parandalimit, kontrollit dhe përhapjes së sëmundjeve epidemike të kafshët,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët Kontraktuese me qëllim që të parandalojnë hyrjen në territorin e shteteve të tyre të sëmundjeve ngjitëse infektive nga kafshët dhe produktet me origjinë shtazore, me ndikim në shëndet, do të bashkëpunojnë për të siguruar territorin e shteteve të tyre nga sëmundjet epizootike si pasojë e importit, eksportit dhe transitit të kafshëve, produkteve dhe materialeve të papërpunuara me origjinë shtazore dhe mallrave të tjera të cilat mund të jenë bartëse të organizmave patogjene.

Neni 2

Autoritetet kompetente për zbatimin e Marrëveshjes janë si më poshtë:

- Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë - Drejtoria e Veterinarisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

- Për Qeverinë e Republikës së Moldavisë- Drejtoria e Përgjithshme e Mjekësisë Veterinare dhe Inspektorati Veterinar Shtetëror i Ministrisë së Bujqësisë dhe Industrisë Ushqimore.

Neni 3

1.Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën pa vonesë:

a) Rreth identifikimit të sëmundjeve të listës “A” të Kodit të Shëndetit të Kafshëve të Zyrës Ndërkombëtare të Epizootive (OIE).

b) Rreth identifikimit të sëmundjeve në kafshë të cilat nuk kanë qenë të pranishme në territorin e Republikës së Moldavisë dhe atyre në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të cilat nuk janë

përhapur gjatë disa viteve.

c) Njoftimet të jenë në përputhje me rregulloret e OIE-së.

2. Në rast nevojë palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën mbi praninë e sëmundjeve të listës "B" të Kodit të Shëndetit të Kafshëve të Zyrës Ndërkombëtare të Epizootive (OIE).

3. Në rast të pranisë së një prej sëmundjeve të përshkruara në pikën a të paragrafit 1, neni 2, në territorin e një prej shteteve të palëve kontraktuese, ato do të ndihmojnë reciprokisht në diagnostifikimin e shkaktarit dhe nëse është e nevojshme do të shkëmbejnë reciprokisht kulturat e patogeneve të izoluar.

4. Palët kontraktuese do të shkëmbejnë reciprokisht raporte mujore rreth situatës së sëmundjeve në kafshë në të dy vendet, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Moldavisë.

Neni 4

Me qëllim zhvillimin e bashkëpunimit në sektorin e veterinarisë dhe lehtësimin e kërkimeve shkencore palët, kontraktuse:

a) zhvillojnë bashkëpunimin midis institucioneve veterinarë dhe diagnostike;

b) do të ndihmojnë shkëmbimin e revistave teknike specifike dhe publikimeve të tjera veterinarë;

c) do të shkëmbejnë aktet normative, rregulloret dhe informacione të tjera specifike në lidhje me ndryshimet e kryera në strukturën organizative të sektorit veterinar;

d) do të informojnë njëra-tjetrën rreth takimeve dhe programeve teknike duke u dhënë mundësinë e pjesëmarrjes ekspertëve nga të dy vendet.

Neni 5

Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin ose zbatimin e Marrëveshjes do të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve midis palëve kontraktuese.

Neni 6

Shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të mbulohen nga secila palë kontraktuese, brenda kufijve të alokimeve të përcaktuara për arritjen e qëllimeve të caktuara.

Neni 7

Me pëlqimin reciprok të palëve kontraktuese marrëveshja mund të shtohet apo të modifikohet përmes protokolleve të veçanta, që bëhen pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Protokolli do të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 8.

Neni 8

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 ditë pas njoftimit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, lidhur me plotësimin e procedurave të brendshme që nevojiten për hyrjen në fuqi, nga palët kontraktuese.

Çdo palë kontraktuese mund të denoncojë fuqinë e kësaj Marrëveshjeje duke lajmëruar palën tjetër kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, tre muaj para përfundimit të saj, duke shprehur vullnetin për ndërprerjen e efekteve të saj.

Bërë në Kishinjev, më 1 nëntor 2004, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, moldave dhe angleze, të gjitha tekstet me të njëjtën vlerë ligjore.

Në rast keqkuptimi në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze mbizotëron.